

Ballina > Kronikë



Like 106 Share

09 April 2020 13:39



Foto: Koha / Ilustrim

Arrestohet një person në Bërnjak pasi dyshohet se e vrau e më pas dogji vëllain e vet

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton se është arrestuar personi me inicialet G.K. nga fshati Bërnjak, Komuna e Rahovecit, i cili sipas hetimeve të para dyshohet për veprën penale “Vrasja e Rëndë” të vëllait të tij, personit me inicialet B.K.

Vëllai i tij kishte ardhur nga Zvicra në Kosovë, e fillimisht ishte paraqitur si i zhdukur nga familjarët e tij që nga data 14.02.2020.

“Pas veprimeve hetimore nga ana e Prokurorisë dhe Policisë, dyshohet se personi G.K. e ka vrarë dhe më pastaj e ka djegur trupin e të ndjerit B.K. ku në vendin e ngjarjes janë evidencuar disa kocka njeriu”, thuhet në njoftimin e prokurorisë.

Po ashtu, pas një pune operative është gjetur edhe arma me të cilën dyshohet të jetë kryer vepra penale, si dhe një gëzhoje e cila pas ekzaminimit të forenzikës është vërtetuar se është shkrepur nga arma e të dyshuarit.

“Gjatë intervistimit në polici, ku prezent ka qenë edhe prokurori i rastit, i dyshuari G.K. e ka pranuar veprën për të cilën dyshohet, duke përshkruar në hollësi mënyrën se si ka vepruar në ditën kritike. Me urdhër të prokurorit të rastit, i dyshuari është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, me dyshimin e veprave penale “Vrasja e Rëndë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe ndaj tij, brenda afatit ligjor do të kërkohet masa e paraburgimit nga Gjykata kompetente në Gjakovë”, përfundon raportin.

@ KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

#BERNJAK #VELLA #VRASJE #ARRESTIM

Taboola Feed



Rrudhat do të zhduken vetëm për 9 ditë! Pa botoks , 15 vjet me e re

Shendeti | Sponsored



Nëse keni këto shenja, diheni se trupi juaj është...

Germiotox | Sponsored



Kjo eliminon të gjitha dhimbjet e kockave....

Osteilfe Premium | Sponsored



Përleshje mes disa shtetasve të huaj në Prishtinë, një i plagosur



17-vjeçari i plagosur dje në Prishtinë ndërroi jetë



86 vjeçarja që jetonte e vetme në Gjilan gjendet e vdekur në shtëpi

BASHKIM (Gani) HOTI

KATEGORITË E VEPRAVE:

- MASHTRIM

PËRSHKRIMI:

ADRESA:

MOSHA:

KUË:

64 VJEÇ



Policia kërkon ndihmë nga qytetarët për kapjen e një të dyshuari për mashtrim

Komentet

Shta koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

☐ I'm not a robot

reCAPTCHA

Privacy - Terms


Posto



Kosovari që shkaktoi aksidentin fatal në Gjermani dënohet me...




Prokuroria: 21-vjeçari prishinas pësoi sulm në tru nga rrahja e rëndë që...



Prokuroria e akuzon Zoran Vukotiqin për dhunimin e gruas shtatzënë



Policia në Pejë kërkon ndihmë nga qytetarët për kapjen e një të dyshuari




Gjendet në Vushtri një 23 vjeçar i pajetë



Dhuhohet një grua në Podujevë

Kohane



Zhduket mitrovicasi 34 vjeçar që nga Tirana u premonte shqiptarëve...

Kohane

Lexo edhe:



Një muaj paraburgim për personin që u prezantua rrejshëm me dokument të vëllait binjak



Arrestohen dy të dyshuar për vrasjen e 29 vjeçarit në Pejë në shtatorin e vitit të kaluar




Një polic vret një person në Gjilan, arrestohet

TË NGJASHME




Arrestohet një 43 vjeçar në Mitrovicë, në prezencë të tij një fëmijë shkrepse me armë zjarri

2 orë më parë




Një muaj paraburgim personit në Rahovec që dyshohet se vrau e pastaj dogji vëllain e vet

9 orë më parë




Ndalohe shoferi i automjetit i cili goditi motoçiklistin për vdekje

10 orë më parë



Një muaj paraburgim për policin që rrahu 21 vjeçarin në Prishtinë

11 orë më parë



Ndalohe 76 persona që nuk respektuan masat e qeverisë për kufizim të lëvizjeve

14 orë më parë



Policia jep detaje për vrasjen në Bërnjak të Rahovecit

14 orë më parë